

VENDIM
Nr.156, datë 11.2.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.78, DATË 8.2.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË
SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 3.1 e 3.2, me këtë përmbajtje:

“3.1 Përfshihen nga provimet me zgjedhje kandidatët, që kërkojnë të vazhdojnë studimet në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Akademinë e Arteve dhe në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Në këtë rast, pranimi i kandidatëve bëhet me konkurs të organizuar nga institucioni publik i arsimit të lartë përkatës. Në rast aplikimi për programe të tjera studimi, këta kandidatë u nënshtrohen provimeve me zgjedhje të maturës shtetërore.

3.2 Përfshihen nga provimet me zgjedhje kandidatët që kanë mbaruar arsimin e mesëm dhe të lartë përpara vitit 2006 dhe kërkojnë të vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në formën e studimit me kohë të pjesshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha